



**KOLEGJI
UNIVERSITAR
QIRIAZI**

**KOLEGJI UNIVERSITAR “QIRIAZI”
NJËSIA E SIGURIMIT TE BRENDSHËM TË CILËSISË**

Adresa: Kodër - Kamëz, Tiranë. www.qiriazi.edu.al ,Tel/Fax: ++355 47 200 111; Mob. ++355(0)69 40 94 516

**RAPORTI I NJSBC PËR VITIN
AKADEMIK 2024-2025**

Tabela e Përmbajtjes

<i>Shkurtime</i>	3
I. Programet e Ofruara nga Kolegji Universitar “Qiriazi”	
1.1 Të dhëna mbi programet e ofruara nga KUQ, viti akademik 2024 – 2025	4
II. Të dhëna mbi studentët dhe pedagogët për vitin akademik 2024 -2025	
2.1 Numri i përgjithshëm i studentëve të regjistruar sipas programeve të studimit	6
2.2 Numri i studentëve të transferuar sipas programeve	7
2.3 Numri i përgjithshëm i studentëve të diplomuar	8
2.4 Studentët e ekselencës	9
2.5 Numri i përgjithshëm i personelit akademik	10
III. Sigurimi i brendshëm dhe i jashtëm i cilësisë në KUQ	
3.1 Sigurimi i brendshëm i cilësisë	11
3.2 Sigurimi i jashtëm i cilësisë dhe akreditime	11
3.3 Përbërja dhe funksionet	11
3.4 Të dhënat e anëtarëve të NJSBC për vitin akademik 2024-2025	12
3.5 Plani i pënës së NJSBC për vitin akademik 2024-2025	13
3.6 Realizimi i veprimtarisë së NJSBC-së për vitin akademik 2024-2025	16
3.7 Shpenzime financiare në funksion të procesit mësimor, viti akademik 2024-2025	18
3.8 Komunikimi i KUQ me institucionet gjatë vitit akademik 2024-2025	18
3.9 Mekanizmat e sigurimit të brendshëm të cilësisë në IAL dhe rezultatet e gjetjeve	22
IV. Vlerësimi i Institucionit dhe Rekomandime	
.....	44

SHKURTIME

KUQ	Kolegji Universitar “QIRIAZI”
NJSBC	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë
SBSC	Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë
ASCAL	Agjencia e Sigurimit të Cilësisë të Arsimit të Lartë
IAL	Institucioni i Arsimit të Lartë
MAS	Ministria e Arsimit dhe Sporteve
QSHA	Qendra e Shërbimeve Arsimore
KGSCI	Komisioni i Garantimit të Standardeve të Cilësisë të Institucionit
ZBNJ-PA	Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Protokoll – Arkivi
ZMJP&KK	Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë e Pranimeve dhe Këshillimit për Karrierë
FE	Fakulteti Ekonomik
FD	Fakulteti i Drejtësisë
FESHSS	Fakulteti i Edukimit, Shkencave Sociale dhe Sportit
KPL	Kolegji Profesional i Lartë
DF	Departamenti i Financës
DMB	Departamenti i Menaxhim Biznesit
DDPP	Departamenti i të Drejtës Publike dhe Penale
DDCB	Departamenti i të Drejtës Civile dhe Biznesi
DEFS	Departamenti i Edukimit fizik dhe Sporteve
DESHSRS	Departamenti i Edukimit, Shkencave Sociale dhe Rekreacionit Sportiv
DTUT	Departamenti i Teknologjisë Ushqimore dhe Turizmit
DTI	Departamenti i Teknologjisë së Informacionit

I. PROGRAMET E OFRUARA NGA “KUQ”

1.1 Të dhëna mbi programet e ofruara nga KUQ për vitin akademik 2024 - 2025

Në përputhje me vendimet e Këshillit të Ministrave në Kolegjin Universitar “Qiriazi” funksionojnë programet e studimit sipas Fakulteteve dhe Departamenteve si më poshtë:

Të Dhënat e Përditësuara të Hapjes dhe Licensimeve/ Akreditimeve të Programeve të Studimit						
1	Fakulteti i Ekonomisë	Departamenti “Financë”	Msc. Financë	UMASH, Nr. 46, datë 09.02.2012	Kodi i Programit: 72MS0412S	Akredituar Nr. 106 (11.02.2019 - 09.30.2021) Akredituar BA Nr. 138 (09.13.2024 - 09.12.2026)
		Departamenti “Menaxhim Biznesi”	Msc. Administrim Biznesi	UMASH, Nr. 46, datë 09.02.2012	Kodi i Programit: 72MS0413S	Akredituar Nr. 70 (10-04-2019 deri 09-30-2021). Akredituar BA Nr. 140 (13.09.2024 deri më 09-12-2028)
		Departamenti “Financë”	Bachelor “Financë”	UMASR, Nr.208, datë 03.07.2020	Kodi i Programit: 63BA0412S	Akredituar BA Nr. 137 (13.09.2024 deri më 09-12-2027)
			Bachelor “Menaxhim Biznesi”	UMASR, Nr.204, datë 03.07.2020	Kodi i Programit: 63BA0413S	Akredituar BA Nr. 139 (13.09.2024 deri më 09-12-2028)
		Departamenti “Menaxhim Biznesi”	Bachelor “Informatikë Ekonomike dhe Biznesi”	UMASR, Nr.263, datë 19.07.2021	Kodi i Programit: 63BA0688S	Akredituar BA. Nr. 217(14.12.2024)deri në përfundim të studimeve të studentëve regjistruar në këtë program studimi

			Bachelor "Menaxhim Hoteleri – Turizëm"	UMASR, Nr.262, datë 19.07.2021	Kodi i Programit: 63BA0488S	Akredituar BA Nr. 142 (13.09.2024 deri më 09-12-2027)
2	Fakulteti i Drejtësisë	Departamenti "E Drejtë Civile dhe Biznesi"	Program me karakter profesional "Asistent Ligjor dhe Administrativ"	UMAS, Nr.384, datë 08.07.2022	Kodi i Programit: 52PP0488S	Akredituar BA. Nr. 218(14.12.2024 deri në 13.12.2028)
		Departamenti "E Drejtë Publike dhe Penale"	PIND (MSC)	UMASR, Nr.215, datë 03.07.2020	Kodi i Programit: 75MI0421S	
3	Fakulteti i Edukimit, Shkencave Sociale dhe Sportit	Departamenti "Edukim Fizik dhe Sporte"	Bachelor "Edukim Fizik dhe Sporte"	UMASR, Nr. 273, datë 21.07.2021	Kodi i Programit: 63BA1014S	Akredituar BA Nr. 141 (13.09.2024 deri më 09-12-2027)
		Departamenti Edukimi, Shkencave sociale dhe Rekreacionit Sportiv"	Program me karakter profesional "Kujdes Social dhe Shëndetësor"	UMASR, Nr.408, datë 14.07.2022	Kodi i Programit: 52PP 0988S	Akredituar BA Nr. 136 (13.09.2024 deri më 09-12-2028)
4		Dep. i Teknologjisë Ushqimore dhe Turizmit	Hoteleri- Turizëm	UMASR, Nr. 401, datë 23.07.2019	Kodi i Programit: 52PP1013S	Akredituar BA Nr. 71(10.09.2022 deri më 09-09-2026)
			"Teknologji ushqimore" në profilet "Teknologji e pijeve dhe ujit", "Teknologji e produkteve bimore" dhe	UMASR, Nr. 451, datë 25.07.2018	Kodi i Programit: 52PP0721S	Akredituar BA Nr . 83 (04.11.2022 deri më 11-03-2025)

KPL		"Teknologji e produkteve shtazore"			
	Dep. Teknologji Informacioni	Teknologji informacioni", në profilet "Teknologji informacioni dhe komunikim", "Elektronikë" dhe "Web Design"	UMASR, Nr. 412, datë 13.07.2018	Kodi i Programit: 52PP0688S	Akredituar BA Nr. 70, (10.09.2022 deri më 09-09-2025)

II. TË DHËNA MBI STUDENTËT DHE PEDAGOGËT (2024 – 2025)

2.1. Numri i përgjithshëm i studentëve të regjistruar sipas programeve

Tabela 1

STUDENTË TË REGJISTRUAR NË PROGRAMET E CIKLIT TË PARË "BACHELOR" DHE PROGRAME PROFESIONALE SIPAS FAKULTETEVE	
FAKULTETI I EKONOMISË	31
Menaxhim Biznesi	13
Informatikë Ekonomike	3
Menaxhim Hoteleri Turizmi	10
Financë	5
FAKULTETI I DREJTËSISË	6
Asistentë ligjor dhe administrativ	6
FAKULTETI I EDUKIMIT, SHKENCAVE SOCIALE DHE SPORTIT	82
Edukim Fizik dhe Sporte	70
Kujdesi Social dhe Shëndetësor	12
TOTALI	119

Tabela 2

STUDENTË TË REGJISTRUAR NË PROGRAMET E CIKLIT TË DYTË "MASTER I SHKENCAVE" SIPAS FAKULTETEVE	
FAKULTETI I EKONOMISË	19
Administrim Biznesi	13
Financë	6
FAKULTETI I DREJTËSISË	6
Master i Integruar në Drejtësi	6
TOTALI	25

Tabela 3

STUDENTË TË REGJISTRUAR NË KOLEGJIN PROFESIONAL TË LARTË	
Teknologji Ushqimore	11
Hoteleri Turizëm	13
Teknologji Informacioni	7
TOTALI	31

2.2. Numri i studentëve të transferuar sipas programeve (2024 – 2025)**Tabela 4**

STUDENTË TË TRANSFERUAR NË PROGRAMET E CIKLIT TË PARË "BACHELOR" DHE PROGRAME PROFESIONALE SIPAS FAKULTETEVE	
FAKULTETI I EKONOMISË	8
Menaxhim Biznesi	2
Informatikë Ekonomike	3
Financë	1
Menaxhim Hoteleri - Turizëm	2
FAKULTETI I DREJTËSISË	1
Asistentë ligjor dhe administrativ	1
FAKULTETI I EDUKIMIT, SHKENCAVE SOCIALE DHE SPORTIT	5
Edukim Fizik dhe Sporte	3
Kujdesi Social dhe Shëndetësor	2
TOTALI	14

Tabela 5

STUDENTË TË TRANSFERUAR NË PROGRAMET E CIKLIT TË DYTË "MASTER I SHKENCAVE" SIPAS FAKULTETEVE	
FAKULTETI I EKONOMISË	4
Administrim Biznesi	2
Financë	2
FAKULTETI I DREJTËSISË	2
Master i Shkenca në Drejtësi	2
TOTALI	6

Tabela 6

STUDENTË TË TRANSFERUAR NË KOLEGJIN PROFESIONAL TË LARTË	
Teknologji Ushqimore	1
Hoteleri Turizëm	
Teknologji Informacioni dhe Komunikimi	
TOTALI	1

2.3. Numri i përgjithshëm i studentëve të diplomuar (2024-2025)**Tabela 7**

STUDENTË TË DIPLOMUAR NË PROGRAMET E CIKLIT TË PARË "BACHELOR" DHE PROGRAME PROFESIONALE TË FAKULTETEVE	
FAKULTETI I EKONOMISË	25
Menaxhim Biznesi	8
Informatikë Ekonomike	5
Menaxhim Hoteleri Turizmi	4
Financë	8
FAKULTETI I DREJTËSISË	10
Asistentë ligjor dhe administrativ	10
FAKULTETI I EDUKIMIT, SHKENCAVE SOCIALE DHE SPORTIT	33
Edukim Fizik dhe Sporte	23
Kujdesi Social dhe Shëndetësor	10
TOTALI	68

Tabela 8

STUDENTË TË DIPLOMUAR NË PROGRAMET E CIKLIT TË DYTË "MASTER I SHKENCAVE" SIPAS FAKULTETEVE	
FAKULTETI I EKONOMISË	20
Administrim Biznesi	11
Financë	9
FAKULTETI I DREJTËSISË	1
Master i Shkenca	1
TOTALI	21

Tabela 9

STUDENTË TË DIPLOMUAR NË KOLEGJIN PROFESIONAL TË LARTË	
Teknologji Ushqimore	7
Hoteleri Turizëm	8
Teknologji Informacioni dhe Komunikimi	4
TOTALI	19

2.4. Studentët e ekselencës gjatë vitit akademik (2024-2025)

NUMRI I STUDENTËVE EKSELENTË NË PROGRAMET E CIKLIT TË PARË, CIKLIT TË DYTË DHE PROGRAMET PROFESIONALE		
	Viti III	Viti II
Bch. Informatikë Ekonomike dhe Biznesi	9.7	
MSc. Administrim Biznesi		9.7

2. 5. Numri i përgjithshëm i personelit akademik (2024-2025)

Gjatë vitit akademik 2024-2025 në KUQ janë angazhuar 55 pedagogë (*me kohë të plotë*) dhe 20 pedagogë (*me kohë të pjesshme*). Raporti student pedagogë është afro 1 me 6 duke mundësuar punën intensive me studentët për të mbështetur e monitoruar nga afër rritjen e tyre cilësore e profesionale vit pas viti.

Politika e KUQ në këtë drejtim është të tërheqë staf të kualifikuar kryesisht me grada e tituj shkencorë, standard i përcaktuar në strategjinë e zhvillimit të institucionit.

Për këtë vit u rekrutuan si staf i brendshëm tre pedagogë me titullin “Doktor i shkencave” dhe dy me “Master i shkencave” (Të dy personat me gradën Msc. I janë dedikuar programit të KPL).

III. SIGURIMI I BRENDSHËM DHE I JASHTËM I CILËSISË NË KUQ

3.1. Sigurimi i brendshëm i cilësisë¹

Bazuar në Statutin e Kolegjit Universitar “Qiriazi” (në vijim KUQ) sigurimi i brendshëm i cilësisë vlerëson dhe garanton cilësinë e ushtrimit të veprimtarisë akademike dhe administrative në IAL.

Sigurimi i brendshëm i cilësisë në KUQ realizohet ku përmes strukturave hierarkike organizative (organet drejtuese dhe autoritetet) të KUQ, planifikojnë, organizojnë dhe garantojnë zbatimin e politikave, strategjive dhe procedurave për realizimin e vizionit të tij.

NJSBC vlerëson dhe harton raportin përkatës të vlerësimit të brendshëm. Raport, i cili diskutohet në të gjitha njësitë e KUQ me synim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në kryerjen e këtyre veprimtarive në të ardhmen.

3.2. Sigurimi i jashtëm i cilësisë² dhe akreditime

Sigurimi i jashtëm i cilësisë së KUQ kryhet nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) ose agjenci të tjera të autorizuara pas përfundimit të raportit të vlerësimit të brendshëm.

3.3. Përbërja dhe funksionet e NJSBC (2024-2025)

Krijimi dhe funksionimi i NJSBC në KUQ mbështetet në nenin 103 të Ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në aktet nënligjore në zbatim të ligjit si dhe në Statutin e KUQ, neni 51. *Njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë* (NJSBC) është një strukturë autonome e përhershme e IAL.

Bazuar në Statut, përbërja e kësaj njësie është 5 anëtarë: katër prej të cilëve përfaqësojnë njësitë kryesore dhe nuk mbajnë funksione drejtuese, ndërsa anëtari i pestë rekomandohet nga këshilli studentor. Anëtarët e NJSBC miratohen nga Senati Akademik pasi përzgjidhen nga Rektori i KUQ. Për vitin akademik 2024-2025 ndryshimet në stafin e NJSBC janë paraqitur në tabelën 11.

¹ Statuti i KUQ, Neni 51 “*Sigurimi i brendshëm*”.

² Statuti I KUQ, neni 52. “*Sigurimi i brendshëm i jashtëm i cilësisë, akreditimi dhe auditimi*”

NJSBC edhe gjatë vitit akademik 2024 - 2025 vlerësoi periodikisht, rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore - shkencore, ka hartuar relacione dhe propozuar ndryshime për përmirësime të nevojshme, mbështetur në udhëzimet e sigurimit të cilësisë në hapësirën evropiane të arsimit të lartë.

Kjo njësi ka organizuar punën në bashkëpunim me njësitë bazë, komisionin për garantimin e standardeve të cilësisë, për kontrollin dhe sigurimin e brendshëm të cilësisë sipas standardeve shtetërore të cilësisë, si dhe duke respektuar lirinë akademike në procesin e mësimdhënies/ mësimnxënies.

Në fillim të vitit akademik NJSBC 2024-2025 ka hartuar planin e veprimtarisë së saj në funksion të ruajtjes dhe zhvillimit të procesit të sigurimit të brendshëm të cilësisë. NJSBC ka përgatitur gjatë këtij viti akademik raportet sipas fushave të veprimit të saj.

3.4. Të dhëna për anëtarët e NJSBC gjatë vitit akademik 2024-2025

Tabela 11

Anëtarët e NJSBC		Detyra që kanë në NjBSC
1	Dr. Ida Kruti	Kryetar (FD) (Tetor 2024 – Janar 2025)
	Dr. Proc. Sara Uldedaj	Kryetar (FD) (Janar 2025 – Tetor 2025)
2	Dr. Stavri Bello	Anëtar (FESHSS)
3	Dr. Proc. Denisa Cani	Anëtar (FE)
4	Dr. Proc. Luana Harizaj	Anëtar (KPL)
5	Anxhel Rrushi	Anëtar (përfaqësues i studentëve)

3.5. Plani vjetor i punës së NJSBC viti akademik 2024-2025

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë të Kolegji Universitar “Qiriazi”, bazuar në Planin Vjetor të Institucionit si dhe Rregulloren e NJSBC, neni 8 dhe 9 për realizimin e detyrave ka hartuar planin e veprimit për vitin akademik 2024-2025 si më poshtë:

Nr.	Detyra me karakter të përgjithshëm	Komente	Përgjegjësi	Afati i zbatimit
1.	Hartimi i raportit vjetor 2023 – 2024 të NJSBC	Diskutim me anëtarët e NJSBC	NJSBC	15 Nëntor 2024
2.	Hartimi i planit të veprimtarive kryesore 2024 – 2025. Paraqitja me shkrim rektorit të IAL, dekanëve të fakulteteve dhe drejtorit të KPL. Për njohje Bordit të Administrimit, njësisë kryesore dhe atyre bazë.	Anëtarët e NJSBC	NJSBC	Nëntor 2024
3.	Monitorimi i punës me qëllim zbatimin e mekanizmave për sigurimin e brendshëm të cilësisë në IAL	Diskutim me anëtarët e KGSCI & PS	KGSCI & PS	Viti Akademik 2024 - 2025
4.	Konkretizim i politikave për sigurimin e cilësisë bazuar në Ligjin Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”	Diskutim me anëtarët e NJSBC, konsultime me drejtuesit e njësisë kryesore dhe bazë, si dhe KGSCI & PS	Grupi i NJSBC KGSCI & PS	Tetor - Nëntor 2024
5.	Rishikimi i rregullores së IAL dhe rregulloreve të tjera	Propozimin për për përmirësimet përkatëse në instancat drejtuese të Institucionit.	Grupi i NJSBC KGSCI & PS	Dhjetor 2024
6.	Ndjekja e mbarëvajtjes së procesit akademik sipas programit vjetor të veprimtarive kryesore dhe planeve mësimore dhe përcaktimit të strukturave mësimore të miratuara në të tre Fakultetet dhe KPL		Grupi i NJSBC në bashkëpunim me drejtuesit e njësisë kryesore e bazë	Gjatë vitit akademik

7.	Bazuar në pikën 4 të Ligjit Nr. 80/2015, NJSBC bashkëpunon gjatë vitit me ZMJP&KK me qëllim evidentimin e të dhënave mbi punësimin e studentëve të KU “Qiriazi”	Diskutim në NJSBC, me ZMJP&KK për të vlerësuar efikasitetin e programeve të studimit të ofruara nga IAL jonë.	Grupi i NJSBC në bashkëpunim me ZMJP&KK	Gjatë vitit akademik
8.	Zbatimi i udhëzimeve të MAS dhe informimi i personelit me aktet dhe udhëzimet e reja që vinjë nga <u>Ministria</u> dhe ASCAL	Diskutim me drejtuesit e njësive dhe stafit	Grupi i NJSBC, Njësi kryesore & bazë	Gjatë vitit akademik
9.	Miratimi i formularit të kërkimit shkencor në bashkëpunim me ZMJP & KK për vlerësimin e performancës së punës shkencore për vitin akademik 2023-2024.		NJSBC ZMJP&KK	Nëntor 2024
10.	Analizë dhe marrje e masave për plotësimin e rekomandimeve të VBA. mbi akreditimin periodik institucional të KUQ, si dhe akreditime të tjera të kryera gjatë vitit akademik 2023-2024.	Diskutime dhe hartimin e planeve të veprimit brenda 6 muajve	Rektori Grupi i Punës NJSBC	Dhjetor 2024 - Shkurt 2025
11.	Përgatitje modeleve për zbatimin e ligjit të arsimit të lartë 80/2015, akteve nënligjore,	Terheqja e mendimeve të grupit të NJSBC nga njësitë kryesore dhe bazë për këto modele.		
	a. Modelin e Programeve të Lëndës (Syllabuseve),	Diskutim në NJSBC, pastaj i dërgohet Rektorit, për miratim përfundimtar dhe realizohen ato nga NJSBC.	Anëtarët Kryetari i NJSBC	Tetor 2024 e në vijim
	b. Modelin e tezës së provimit,			
	c. Modelin e monitorimit në orën e mësimi.			
12.	Përgatitja dhe miratimi i pyetësorëve për studentët e të gjithë programeve dhe KPL	Diskutim mbi ndryshime të pyetësorëve aktual	NJSBC	Dhjetor 2024

13.	Organizimi i pyetësorëve për studentët e programeve bachelor, master i shkencave programet e studimit me karakter profesional dhe KPL		NJSBC	15 – 30 Janar 2025 26\05 – 06\06\ 2025
14.	Përgatitja dhe miratimi i pyetësorëve për pedagogët e KU“Qiriazi“	Diskutim mbi ndryshime me pyetësorët aktual	NJSBC	Dhjetor 2024
15.	Organizimi i pyetësorëve për pedagogët e KU“Qiriazi“		NJSBC	Maj – Qershor 2025
16.	Përpunimi i rezultateve i pyetësorëve të studentëve dhe paraqitja e tyre me shkrim rektorit të IAL, dekanëve të fakulteteve dhe drejtorit të KPL. Njohje me konkluzionet Bordit të Administrimit, njësave kryesore dhe ato bazë.	Rezultatet e tyre bëhen pjesë e diskutimeve në rektorat dhe fakultetet dhe departamentet përkatëse.	NJSBC	Korrik 2025
17.	Përpunimi i rezultateve nga pyetësorët e plotësuar nga pedagogët dhe paraqitja e tyre me shkrim rektorit të IAL, dekanëve të fakulteteve, drejtorit të KPL.	Diskutim në NJSBC, pastaj i dërgohet Rektorit.	Grupi i NJSBC	Korrik 2025
18.	Realizimi i relacioneve mbi kalendarët e kontrollit semestralë të kontrollit të brendshëm të cilësisë për programet mësimore në ciklet e studimit: Bachelor, Master i Shkencave si dhe programet e studimit me karakter profesional dhe KPL.	Diskutim në NJSBC, pastaj i dërgohen Rektorit	Grupi i NJSBC	Tetor 2024 e në vijim
19.	Monitorimin në njësitë bazë për masat e marra në:	Organizim tryeze të rumbullakët të NJSBC me njësitë kryesore dhe bazë për problemet që kanë dalë gjatë vitit të kaluar dhe të rejtat që shtohen për këtë vit akademik.	Grupi i NJSBC në bashkëpunim me drejtuesit e njësave kryesore e bazë	Gjatë vitit akademik

	a. Organizimin e praktikave profesionale			
	b. Hartimin e çeshtjeve kryesore nga modulet, apo vënja në dispozicion të studentëve të materialeve për provimin përfundimtar (të diplomimit)			
	c. Përcaktimin e temave të diplomave dhe i pedagogëve udhëheqës.			
20.	Organizimi në fund të çdo semestri i një takimi të studentëve me pedagogët e Fakulteteve dhe KPL mbi ecurinë e studentëve sugjerimet dhe problematikat e tyre gjatë semestrave dhe viti akademik, me qëllim evidentimin dhe marrjen e masave për një mbarëvajtje sa më të mirë të procesit mësimor.	Grupi i NJSBC në bashkëpunim me drejtuesit e njësisë kryesore e bazë	Grupi i NJSBC në bashkëpunim me drejtuesit e njësisë kryesore e bazë	Shkurt - Qershor 2025

3.6. Realizimi i veprimtarive të parashikuara nga NJSBC (2024-2025)

Puna e kësaj njësie ashtu sikurse kemi përmendur më lart është e bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, Nr.80/2015 në statut dhe rregulloren e IAL-së dhe NJSBC-së. Para nisjes së aktiviteteve të vitit akademik 2024-2025 është hartuar dhe dorëzuar raporti vjetor i vitit akademik 2023-2024.

Plani i aktiviteteve për vitin akademik 2024-2025 është hartuar në bazë të politikave dhe strategjisë institucionale, përmirësimin, ruajtjen dhe sigurimin e standardeve të cilësisë. Plan i NJSBC-së është hartuar sipas kalendarit akademik 2024-2025 të miratuar nga senati akademik. Kjo njësi si çdo vit ka zhvilluar aktivitetin e saj në bashkëpunim të ngushtë me njësitë kryesore dhe bazë, të cilat njihen me të që në fillim të vitit akademik.

NJSBC është mbledhur për të diskutuar rreth planveprimit të këtij viti akademik, si dhe mënyrat se mund të përmirësonim instrumentat matës të monitorimit. Ndarja e detyrave për çdo anëtar është përcaktuar në takime dhe me email. Gjatë monitorimeve anëtarët kanë patur të qartë rolin dhe elementët matës të cilët shërbejnë për hartimin e

raporteve dhe përmirësimit. Kontrolli i temave të diplomës së ciklit të dytë të studimit, në zbatimin e standardeve të mbrojtjes së temave, si dhe kontrollin e dosjeve të tyre, si qëllim përmbushjen e detyrimeve ligjore me zyrën e administrimit akademik (sekretarinë mësimore). Me kërkesë të rektoratit dhe sugjerim të komisionit të përhershëm për garantimin e standardeve të cilësisë në institucion njësia ka kryer edhe veprime të tjera administrative me qëllim përmirësimin e zhvillimit të procesit mësimor të vitit akademik 2024-2025.

Janë marrë në shqyrtim dhe janë kontrolluar për zbatimin e ligjshmërisë sylabuset e secilit program. Gjatë monitorimit të syllabuseve në të dy semestrat është vërejtur se një përqindje e lartë e pedagogëve ka respektuar formatin sipas VKM 41 (i ndryshuar) dhe është ndërhyrë ku ka patur mospërputhje. Gjatë këtij viti akademik dokumentat janë ruajtur në Folder të veçantë dhe janë shpërndarë në formë elektronike të çdo njësi, duke krijuar dhe arkivin elektronik të kësaj njësie.

NJSBC në konsultim me KGSCI dhe në bashkëpunim me njësitë kryesore dhe ato bazë ka ndërmarrë dhe finalizuar miratim nga senati akademik të rregullores institucionale, rregulloret e njësive kryesore, atyre bazë dhe programeve të studimit.

Në bashkëpunim me Fakultetin e Edukimit, Shkencave Sociale dhe Sportit ka bashkëpunuar duke realizuar disa ndryshime në kurrikulën e dy programeve të studimit deri në masën 20% që ofrohen nga ky fakultet dhe miratimin e tyre në senatin akademik. Në përmbushje jo vetëm të rekomandimeve të Bordit të Akreditimit por edhe si një nevojë imediate NJSBC së bashku me Bordin e Administrimit, si dhe Zyrën e Administrimit akademik (sekretarinë) kanë mundur të përgatitjen e materialeve për funksionimin e platformave PITAGORA dhe MOODLE për përdorim, si nga pedagogët, studentët, ashtu edhe nga zyra e administrimit akademik.

Lidhur me realizimin e pyetësorëve të studentëve janë kryer javën e XIV dhe XV të procesit mësimor. Në semestrin e parë studentëve u është dërguar linku që u përgatit në Google Forms nga anëtarët e NJSBC, ndërsa në semestrin e dytë pyetësori u krye përmes formatëve fizik. Pyetësori i pedagogëve u shpërnda në javën e XIV të semestrit të dytë dhe u plotësua në kohë nga ana e tyre. Lidhur me pyetësorët si të studentëve dhe pedagogëve është ruajtur gjithmonë anonimat. Pas vlerësimit dhe përpunimit të të

dhënave janë hartuar raportet të cilat u janë vendosur në dispozicion: rektorit, drejtuesve të njësisë kryesore dhe atyre bazë.

Të gjitha aktivitetet janë dokumentuara dhe protokolluar me datat përkatëse në protokoll dhe në dosjen e NJSBC të dorëzuar në Rektorat.

3.7. Shpenzime financiare në funksion të procesit mësimor

Në plotësim të standardeve shtetërore akademike dhe infrastrukturore, në përputhje me Kodin e Cilësisë, Senati Akademik i KUQ në bashkëpunim me Bordin Administrativ ka zbatuar politika të mirëfillta mbi shpërndarjen e fondeve në funksion të përmirësimit të cilësisë. Konkretisht është përmirësuar infrastruktura informatike, ku çdo auditor është i pajisur me mjete audiovizive dhe videoprojektor, sallat sportive, si dhe ka pasur pasurim me mjete të laboratorit të “Elektronikës dhe Elektroteknikës, si dhe laboratorin e “Teknologjisë së Informacionit”, si dhe libra për bibliotekë.

Gjatë këtij viti akademik ka patur pajisje me mobilje zyrash, mjete për realizimin e pikturave murale, grila për dritare, mjete kancelerie, materiale promovuese (bojë printerash, printer me qera, kartvizita, stilolaps me logo, çanta kartoni, baner etj.). Kuzhina është pajisur me pajisje elektroshtëpiake si: fritezë, sobe gatimi, po gjithashtu janë bërë investime në mirëmbajtje godine (lyerje muri, suvatim, llampa etj) dhe bimë të gjelbërta për amjente të brendshme dhe të jashtme.

Për realizimin e moduleve specifike të lëndëve të programit Edukim Fizik dhe Sporte (lojrat me dorë, not, ski etj.) janë nënshkruar dhe paguhen kontratat e qerasë ose kostot e shfrytëzimit të mjediseve.

3.8. Komunikimi me institucionet

Gjatë këtij viti akademik, si çdo vit tjetër, “KUQ” ka patur një komunikim dypalësh dhe shumë korrekt me MAS, ASCAL, QSHA si dhe strukturat e tjera në varësi të saj. Përsa i përket komunikimit me MAS, “KUQ” gjatë vitit akademik 2024-2025 ka marrë licensimin për hapjen e 2 (dy) programeve të reja të studimit në gjuhë angleze.

1. Msc. Administrim Biznesi
2. Bach. Menaxhim Biznesi

Kontakti me MAS ka vijuar lidhur me kontrollin e pajtueshmërisë së veprimtarisë së IAL-së. Pas ardhjes së drafraportit përfundimtar kemi dërguar dhe planin e veprimit për realizimin të aktiviteteve, nr. 131. Prot. dt. 04.08.2025:

PËR PËRMBUSHJEN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NGA MAS MBI KONTROLLIN E PAJTUESHMËRISË SË VEPRIMTARISË SË KUQ

Nr.	Rekomandime	Masa konkrete	Realizimi	Struktura Përgjegjëse
1	Përditësimi i rregullores së brendshme të institucionit, duke mbajtur në konsideratë pikën 6, të nenit 75 të ligjit nr.80/2015	Përgatitja dhe hartimi i rregullores së brendshme të institucionit, duke mbajtur në konsideratë pikën 6, të nenit 75 të ligjit nr. 80/2015	Grupi i punës	Miratur me VSA, nr.28,dt.14.04.2025 nr. 44, dt.18.07.2025
2	IAL-ja të marrë masa për ndjekjen e procedurës së miratimit të rregulloreve të njësive kryesore dhe njësive bazë sipas shkronjës “e”, të pikës 7, neni 9 i statutit të KUQ	Njësitet kryesore dhe ato bazë reflektuan ndryshimet e duhura dhe u bë miratimi i tyre sipas shkronjës “e”, të pikës 7, neni 9 i statutit të KUQ	Njësitet kryesore Njësitet bazë	Miratur me VSA, FE. nr.42, dt. 18.07.2025 DF. nr.42/4, dt.18.07.2025 DMB. nr.42/5, dt. 18.07.2025 FD. nr.42/1, dt. 18.07.2025 DDPP. nr.42/6, dt. 18.07.2025 DDCB. nr.43, dt. 18.07.2025 FESHSS. nr. 42/2, dt. 18.07.2025 DEFS. nr.42/7, dt. 18.07.2025 DESHSRS. nr.42/8, dt. 18.07.2025 KPL. nr.42/3, dt. 18.07.2025 DTUT. nr 42/9, dt. 18.07.2025 DTI. nr 42/10, dt.18.07.2025
3	IAL të marrë masa për zbatimin e pikës 4 të nenit 25 të ligjit nr.80/2015	Institucioni zbaton aktualisht marrëveshjen me MAS	Rektori	MAS, nr. 2537/8, dt.14.12.2023
4	Institucioni, të marrë masa që vitin e ardhshëm akademik të zbatojë detyrimet e përcaktuara në nenin 59, të ligjit nr.80/2015 dhe VKM 41/2018 lidhur me titullarët e lëndëve.	Institucioni është përpjekur të zbatojë detyrimet e përcaktuara në nenin 59, të ligjit nr.80/2015 dhe VKM 41/2018. Lidhur me titullarët e dy lëndëve të konstatuara, do të merren masa të korrigjohet kjo gjë në vitin akademik 2025-2026.	Njësia kryesore Njësia bazë	Menjëherë dhe në vijimësi

5	Institucioni duhet të marrë masa për mbylljen e programeve konsideruar joaktive në zbatim të nëndarjes C të kreut udhëzimit nr.1, dt.14.01.2020	Institucioni ka marrë masa duke aplikuar për mbylljen e katër programeve të studimit dt.17.01.2025 në portalin e-albania	Njësia kryesore Njësia bazë	Miratuar Urdhër MAS, nr. 148, 1085/3 prot, dt.14.04.2025
6	IAL-ja të marrë masa për depozitimin e regjistrave në arkivën e shtetit, sipas kuadrit ligjor në fuqi për arkivat. Po ashtu ruajtja e respektimit në vijueshmëri e regjistrimeve të studentëve në vitin pasardhës për të njëjtin program studimi në përputhje me rendin numerik të vitit parardhës, saktësuar në mbylljen e regjistrat	Sekretaria mësimore/zyra e administrimit akademik ka marrë tashmë masa a. për akrimin e regjistrave deri në vitin 2016 sipas kuadrit ligjor në fuqi për arkivat. b. duke filluar nga 2024-2025 ka vijuar me respektimin në vijueshmëri të regjistrimit të studentëve në vitin pasardhës për të njëjtin program studimi në përputhje me rendin numerik të vitit parardhës, saktësuar në mbylljen e regjistrat.	Sekretaria mësimore/ zyra e administrimit akademik Zyra e protokoll arshivës.	Menjëherë dhe në vijimësi
7	IAL-ja të marrë masa që kontratat e shërbimit me studentët të përmbajnë elementët e udhëzimit nr.7, dt.19.02.2018 MASR, konkretisht pika 4.	IAL ka marrë masa për reflektimin e pikës 4 të udhëzimit nr.7, dt.19.02.2018 MASR për vitin akademik 2025-2026	Zyra e financës NJSBC	U realizua menjëherë kontrata e re me elementët e udhëzimit nr.7, dt.19.02.2018
8	Kontratat e personelit akademik të kategorisë lektor të lidhen sipas përcaktimit neni 59, pika 4 e ligjit nr.80/2015	IAL ka marrë masa që nga viti akademik 2025- 2026 kontratat e personelit akademik të kategorisë lektor të lidhen sipas përcaktimit neni 59, pika 4 e ligjit nr.80/2015	Zyra e burimeve njerëzore	Menjëherë dhe në vijimësi
9	IAL-ja të marrë masa për plotësimin e dokumentacioneve të dosjeve të studentëve që ka	IAL ka marrë masa për plotësimin e dokumentacioneve të dosjeve të studentëve që ka aktualisht dhe në vijimësi	Sekretaria mësimore/ zyra e administrimit akademik	Menjëherë dhe në vijimësi

	aktualisht dhe në vijimësi sipas udhëzimeve të zbatueshme për kohën, kur ndjekin studimet.	sipas udhëzimit nr.12, datë 30.6.2023		
10	IAL-ja të marrë masa në lidhje me punësimin e personelit akademik sipas përcaktimeve të ligjit 80/2015 dhe statutit nr. 214, dt.14.07.2021 të miratuar nga MAS	IAL-ja ka marrë masa të zbatojë punësimin e personelit akademik sipas përcaktimeve të ligjit 80/2015 dhe statutit nr. 214, dt.14.07.2021 të miratuar nga MAS nga viti 2024-2025.	Rektori	Menjëherë dhe në vijimësi
11	KUQ të marrë masa për përmbushjen e detyrimeve, në mënyrë që subjekti të ketë likuiditetin e nevojshëm për mbulimin e detyrimeve	IAL për të siguruar qëndrueshmëri financiare ka lidhur marrëveshje me nr. rep 1346, nr. Kol. 726, dt. 20.06.2022 midis subjekteve Jukoil SHA, me NIPT L18405501L, pjesë e rrjetit të bizneseve të ortakut të vet, njëkohësisht dhe administrator Aleks Uldedaj	Administrator i shoqërisë Aleks Uldedaj	Menjëherë dhe në vijimësi

Në përgjigje të përmbushjes së afateve janë dërguar kriteret e pranimit, si dhe janë ndjekur hapat për plotësimin e kapaciteteve pritëse të IAL-së. Kontakte këto që janë mbajtur jo vetëm në formë shkresore por edhe fizike mes pritjes së grupeve të kontrollit dhe evidentimit konkret në IAL. Gjatë këtij viti akademik 2024-20225 në MAS dhe INSTAT janë dërguar edhe tabelat e raportimit të statistikave mbi Kërkimin Shkencor dhe Zhvillimin (GBARD).

Komunikimi me ASCAL ka filluar me plotësimin e kodeve për çdo program studimi. Ky komunikim ka vijuar me zbardhjen e vendimeve të Bordit të Akreditimit dhe nisjes së procedurës për riakreditimin e dy programeve: Teknologji Informacioni dhe Teknologji Ushqimore. Komunikimi me ASCAL nëpërmjet sistemit online të menaxhimit AMS ka qenë shumë i vlefshëm dhe korrekt për marrjen dhe dërgimin e informacionit në kohë reale. Me ASCAL është mbajtur komunikimi lidhur me planet e veprimit nga çdo program të akredituar dhe riakredituar, si dhe planin e veprimit institucional. Gjatë vitit akademik kemi mirëpritur përfaqësues të ASCAL lidhur me

sondazhin e studentëve i cili ka vijuar me komunikim intensiv deri në përfundim të procesit.

Me QSHA është mbajtur kontakt i pandërprerë lidhur me dërgimin e numrit të studentëve të regjistruar, miratimin e formatit të diplomës për programet e akredituara, pajisjen me regjistra, listat e studentëve që diplomohen, si dhe numrat e matrikullimit.

3.9. Mekanizmat e sigurimit të cilësisë në IAL dhe rezultatet e gjetjeve

Politikat e sigurimit të cilësisë gjatë vitit akademik 2024 -2025 janë realizuar përmes mekanizmave apo “Instrumentave për Matjen e Cilësisë” përcaktuar nga Politikat e Garantimit të Standardeve të Cilësisë të KUQ si:

- Pyetësi për mbledhjen e opinioneve të pedagogut
- Pyetësi i studentëve
- Relacioneve lëndore semestrale
- Veprimtaria kërkimore shkencore e personelit akademik
- Vlerësimin të performancës së personelit akademik
- Performanca akademike e studentëve
- Gjurmimin e studentëve të KUQ
- Funkionimin e klubeve studentore të KUQ
- Marrëdhënia me bashkëpunëtorët në kuadër të marrëveshjeve.


a. Pyetësi i Pedagogëve

- Ky pyetësor organizohet për të kuptuar më mirë pikëpamjet që ka stafi akademik për institucionin në tërësi dhe ndihmon në përmirësimin e mësimdhënies dhe marrëdhënieve institucionale.
- Pyetësi ka qenë anonim, gjë që lejon shprehjen e mendimit të lirë nga ana e pedagogëve dhe ashtu sikurse është i parashikuar pyetësi u realizua në fund të vitit akademik 2024-2025.

Në përfundim të vitit akademik 2024 -2025, NJSBC pasi ka grumbulluar, përpunuar dhe ka hartuar relacionin e përgjithshëm mbi rezultatet e mbledhura, i cili i drejtohet rektorit dhe ju vendos për dijeni Dekanëve të Fakulteteve, të cilët i bëjnë objekt diskutimesh në dekanatet e tyre dhe njësitë bazë. Pyetësi iu shpërnda 30 pedagogëve. Pyetësi u plotësua nga 28 prej tyre.

Lidhur me **aspektin demografik** të pedagogëve që morën pjesë ishin 50% meshkuj, 42.8% femra dhe 7.2% persona të cilët nuk kanë dhënë të dhëna në lidhje me moshën.


Paraqitja grafike e pjesëmarrjes në pyetësor



Pyetësi është plotësuar nga grupmosha të ndryshme duke filluar nga 25 deri mbi 60 vjeç. Të dhënat e detajuara lidhur edhe me gjininë përkatëse i gjeni në grafikun e mëposhtëm:




Në grafikun e mëposhtëm janë paraqitur ciklet e studimit ku pedagogët japin mësim, përkatësisht në ciklin e parë të studimeve, në ciklin Bachelor, në ciklin e dytë Master i Shkencave, në programet 2-vjeçare me karakter profesional, si dhe në Kolegjin Profesional të Lartë. Rreth 3.5 % e të anketuarve nuk ka dhënë informacion mbi ciklin ku japin mësim.




Lidhur me grupin e dytë të pohimeve (Fusha B), që i referohen *aspektit didaktik* të pyetur mbi zotërimin e njohurive paraprake të studentëve për të kuptuar temat pedagogët janë shprehur: shumë shpesh 14%, herë pas here 22%, rrallë 14% dhe pjesa tjetër nuk kanë.

Detajet e pohimeve të fushës B janë paraqitur grafikisht më poshtë:



Pjesa e dytë e fushës B që lidhet me përdorimin e metodave të mësimdhënies. Detajet janë paraqitur në grafikun e mëposhtëm.




Në fushën C pedagogët pyeten mbi marrëdhëniet me institucionin. Kjo fushë gjithashtu ndahet në dy pjesë. Pjesa e parë përfshin marrëdhëniet me organet kolegjiale të institucionit dhe pjesa e dytë përfshin me drejtuesit e njësive.

Në lidhje me vendimet e marra në mënyrë demokratike nga organet kolegjiale shprehen se janë: shumë shpesh dakort 75%, 14% e tyre herë pas here dhe 11% shprehen asnjëherë.

Lidhur me kontributin personal në vendimmarrjen e organeve kolegjiale pedagogët shprehen: 82% shumë shpesh dhe herë pas here, 18 % shprehen rrallë dhe asnjëherë. Përgjigjeve lidhur si vendimet e senatit ndihmojnë në drejtimin e zgjedhjeve të tyre akademike pedagogët përgjigjen, 75% shumë shpesh dhe herë pas here, ndërsa 25% e tyre shprehen, rrallë dhe asnjëherë. Lidhur me përshtatjen që pedagogët u bëjnë programeve të tyre me vendimet e marra kolektivisht, 75% e tyre përgjigjen, shumë shpesh dhe herë pas here, 18 % e pedagogëve shprehen rrallë dhe asnjëherë.

Në pjesën e dytë të fushës C, ku pedagogët pyeten mbi marrëdhëniet me drejtuesit e njësive, 86 % e tyre shprehen se drejtuesit lehtësojnë shpërndarjen në kohë të dokumenteve dhe informacionit, ndërsa 14% e tyre shprehen se kjo nuk ndodh. Nëse drejtuesit promovojnë kolegjalitet për zgjidhjen e problemeve didaktike 82% shprehen “po” dhe 18% shprehen “jo”. Lidhur me elementët e tjerë të kësaj fushe përgjigjet e detajuara gjenden në grafikun vijues:



Fusha D përfshin marrëdhëniet me kolegët. Lidhur me bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit, materialeve dhe përvojave me kolegët 57% e tyre shprehen se kjo “shumë shpesh”, 29% “herë pas here”, 14% shprehen “rallë” dhe “asnjëherë”.

Lidhur me ofrimin e ndihmës për kolegët, kur ata kanë nevojë, komunikimin e lirshëm me ta, pasja e besimit të mjaftueshëm në ndarjen e informacioneve dhe feedbackut me kolegët pedagogët shprehen: 84% “shumë shpesh” dhe “herë pas here”, pjesa tjetër “rallë” dhe “asnjëherë”.

Një nga fushat e rëndësishme lidhet me **marrëdhëniet me institucionin**, ku pedagogët janë shprehur për çështjet si: vlerësimi mbi organizimin e institucionit, përfshirjen e strukturave drejtuese në vlerësimin e studentëve, zbatimin e kryerjes së pagesës, përshtatshmërinë e hapësirave dhe strukturat për pedagogët, apo mbështetjen e institucionit të procesit mësimor me laboratorë dhe pajisje teknologjike funksionale apo shërbimin e sekretarisë etj. Përgjigjet e pedagogëve varrojnë nga 32% - 86% në “shumë shpesh” dhe “herë pas here”, ndërsa nga 7% - 68% përgjigjet variojnë në “rallë” dhe “asnjëherë”.

Lidhur me “Fushën F” mbi *shprehjen e formës së preferuar për zhvillim profesional* shumica prej tyre shprehen për: pjesëmarrje në trajnime disa ditore, në pjesëmarrjen në konferenca, si dhe workshope.

b. Pyetësi i Studentëve

Metodologjia e përdorur është sasiore. Pyetësi ka pesë fusha kryesore, duke përjashtuar fushën e parë që lidhet me të dhënat demografike, fushat e tjera variojnë me nga 4 (katër) deri në 6 (gjashtë) pohime secila. Fusha e dytë dhe e pestë përmbajnë pyetje

të hapura, ku studentët janë të lirë të shprehin opinionet apo sugjerimet e tyre për përmirësim. Në pyetësor morën pjesë 202 (53.4% e studentëve aktiv), studentë të ciklit të parë, ciklit të dytë dhe programeve me karakter profesional 2-vjeçar. Çdo studenti ju dha sqarim nëse kishte pyetje para plotësimit.


Çdo pohim për arsye statistikore u kodua me numra 1-6 maksimumi sipas fushave përkatëse. Përgjigjet po/jo/tjetër, u koduan me numrat 1-3, ndërsa përgjigjet shumë shpesh/ herë pas here/ rrallë/ asnjëherë, u koduan me numrat nga 1 deri në 4. Të gjitha kodifikimet u përkthyen në grafikë me shprehjet e tyre ashtu sikurse dhe në shpjegimet që do të vijojnë sipas fushave. NJSBC ka hartuar të dhënat statistikore përfundimtare duke përpunuar dhe ruajtur anonimatën e secilit prej pjesëmarrësve, gjë që lejon shprehjen e mendimit të lirë.

Në shërbim të rritjes së cilësisë, institucioni bën përpjekje të vazhdueshme për rritjen e mëtejshme të standardeve ekzistuese në kuadër të hapësirës mbarë Evropiane të Arsimit të Lartë.


Rezultate

1. Fusha I - Të dhënat mbi studentët


Grafiku 1- Moshë




Grafiku 2 - Gjinia



Grafiku 3 -Frekuentimi




Grafiku 4- Vendbanimi para studimeve



Fusha II - Pedagogët dhe Leksionet

2.a Pedagogët kanë munguar




2.b Kam komunikim të hapur me pedagogët

Po	Jo
198	


Tjetër (cilëso) – përgjigjet e katër studentëve i gjeni në shtojcat bashkëlidhur sipas fakulteteve.

Rezultatet e tjera lidhur me pohimet e tjera të fushës dy(c,d,e) i gjeni në grafikun e mëposhtëm:




Fusha 3 - Leksionet

Rezultatet e fushës 3 janë në tabelë si më poshtë:




Fusha 4 – Infrastruktura Mësimore




Fusha 5 - Opinione Përfundimtare

a. Jam i/e kënaqur nga ajo që ofron programi im i studimit



- b. Njohuritë paraprake të zotëruara për të ndjekur dhe përvetësuar këtë program anë të mjaftueshme



c. Lënda që më tërheq më shumë (arsyeja):

Lëndët që preferohen nga studentët paraqiten në shtojcat përkatëse për secilin program.

- d. Mendime dhe sugjerime të tjera gjenden gjithashtu në shtojcat për çdo program studimi.

KONKLUZIONE:

Në përgjithësi studentët janë të kënaqur me atë që ofron programi i studimit me mjetet e nevojshme për ushtrimet praktike, pajisjet informatike, mjete laboratorike.

Në përgjithësi leksionet kanë rezultuar të qarta të bazuar në një formim shkencor të kënaqshëm dhe profesional duke i bërë programet e këtyre kurseve interesante dhe tërheqëse për studentët, duke rritur komunikimin midis tyre dhe pedagogëve.

Si pika të forta dhe arritje:

- * Vlerësimet e studentëve në këtë pyetësor janë tregues i angazhimit profesional dhe akademik të stafit mësimdhënës.
- * Pedagogët janë relativisht të përpiktë lidhur me seminaret dhe leksionet duke u mundësuar studentëve të jenë të hapur dhe aktiv.
- * Pedagogët kanë treguar një nivel të mirë profesional.

Për sa i përket mundësive për përmirësim:

- * Rritjen e numrit të studentëve frekuentues në orët e leksioneve.
- * Marrjen e masave për sistemin ngrohje ftohje në klasa
- * Marrja e masave për funksionimin e një sistemi të brendshëm online.

- * Të tregohet kujdes lidhur me qendrat e zhvillimit të praktikës në programet specifike sipas shtojcave.
- * Zyra e karrierës të punojë më shumë duke adresuar problematikat gjatë vitit.

c. Relacione lëndore semestrare

Anëtarët e NJSBC vizitojnë rregullisht çdo fakultet dhe çdo departament dhe ftohen nga ana e tyre për zhvillimin e proceseve të sigurimit të brendshëm të cilësisë. Në veçanti, konsistohet rreth zhvillimit të mekanizmave për sigurimin e cilësisë, duke vlerësuar përdorimin e mësimdhënies moderne, të mësuarit dhe metodat e vlerësimit të studentëve, me qëllim për të promovuar një qasje interaktive me studentin në qendër, metoda e të mësuarit aktiv, duke ndërthurur dimensionin teorik me atë praktik për rritjen e nivelit tekniko-profesional të studentit. Është zhvilluar në mënyrë të rregullt mësimi në auditor me studentët e të gjitha viteve të studimit për çdo program studimi.

Pas përfundimit të procesit të rregullt mësimor me studentët rezultojnë që janë ruajtur standardet bazë të procesit të mësimdhënies dhe në bazë të vlerësimeve dhe verifikimeve të kryera standardet e respektuara. *Standardet* e respektuara, rezultuan të jenë:

1. Realizim i një procesi shpjegimi në formate powerpoint, excel, pdf apo materiale Word.
2. Leksionet apo seminarët/ushtrimet janë realizuar sipas orëve të miratuara.
3. Studentët kanë mundur të aksesojnë leksionet sipas mundësive të tyre fizike dhe teknologjike.

Disa prej pikave të forta të raportuara nga vetë stafi akademik në relacionet e paraqitura pranë Koordinatorit të NJSBC për FD., FE., FESHSS si dhe KPL .

- Realizimi i objektivave të programeve lëndore në mënyrë të kënaqshme.
- Përdorimi dhe shfrytëzimi i literaturës jo vetëm të detyrueshme dhe asaj në gjuhën shqipe por edhe i literaturës bashkëkohore me tituj të huaj e të rëndësishëm për secilën prej fushave të studimit.
- Përditësimi me konceptet moderne të fushave përkatëse.
- Përdorimi i metodave interaktive me në qendër studentin.
- Gërshetimi i teorisë me praktikën.

- Angazhim maksimal me studentët.

Disa prej pika të dobëta të evidentuara kanë qenë:

- Dorëzimi i detyrave dhe projekteve në kohë nga ana e studentëve.
- Vështirësi në interpretimin e koncepteve sipas fushave përkatëse.
- Mungesa e literaturës së viteve të fundit në gjuhën shqipe.

Shënim: Raporti mbi relacionet lëndore semestrale janë hartuar për çdo fakultet dhe KUQ, nr. 199 prot, dt. 03. 07. 2025.

d. Veprimtaria kërkimore shkencore, si dhe mundësi për angazhim të studentëve.

KUQ angazhon në kërkimin shkencor profesorë me tituj dhe grada si pjesë e personelit akademik, duke u kujdesur njëkohësisht që në këtë proces të përfshijë gradualisht me standardet e duhura brezin e ri të pedagogëve me synimin në rritjen dhe kualifikimin e mëtjshëm të tyre. Ndër indikatorët e kualifikimit akademik janë: Gradat dhe titujt shkencore; Eksperienca në fushën e mësimdhënies; Eksperienca profesionale; Botime akademike; Kualifikimet ekstra kurrikulare; etj.,

Në FD gjatë vitit akademik 2024 - 2025 një anëtar i departamentit të FD ka filluar procesin për marrjen e gradës “Doktor i shkencave” MSc. Sara ULDEDAJ. Një nga anëtarët (PAE) e po këtij departamenti ka marrë titullin “Profesor i Asocuar”, Rezana Balla dhe një nga anëtarët (PAK) ka marrë titullin PhD. Xhon Skënderi.

Në FE si pjesë e personelit akademik (PAE) disa anëtarë janë në proces për marrjen e gradës shkencore “Doktor i shkencave”. Gjatë vitit akademik 2024 - 2025 një nga anëtarët e këtij fakulteti filloi procesin e marrjes së titullit “Doktor i Shkencave” Msc. Dr. Proc. Enxhi Canka.

Në KPL si pjesë e personelit akademik (PAE) disa anëtarë gjatë vitit akademik 2024 - 2025 filluan procesin e marrjes së titullit “Doktor i Shkencave” Msc. Dr. Proc. Eva Ceka, Luana Harizaj dhe Bora Qevani.

Këta pedagogë kanë gjetur mbështetjen nga institucioni si nga ana financiare ashtu edhe nga shkëputja kohore e punës për të realizuar objektivat, pa ndalesa në detyrimet financiare të parashikuara në kontratë. Realizimi i veprimtarive kërkimore-shkencore nga ana e strukturave drejtuese dhe përgjegjëse për kërkimin shkencor ka patur mbështetje maksimale për pjesëmarrje në aktivitete shkencore të realizuara fizikisht/virtualish apo botime në revista me faktor impakti krahas një numri të

konsiderueshëm aktivitete të realizuara në ambjentet e KUQ. Të dhëna përmbljedhëse për përfshirjen e stafit dhe studentëve në aktivitete të zhvilluara për vitin 2024 – 2025 janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Tabela 12

Aktivite akademike të pedagogëve dhe studentëve për vitin akademik 2024-2025				
Përfshirja në projekte kombëtare/ ndërkombëtare	Leksione të hapura kombëtare	Konferenca kombëtare/ ndërkombëtare	Leksione dhe trajnime nga lektorë të brendshëm/ të ftuar	Përfshirja studenteve në Mobilitet/ Konferenca, leksione dhe workshope
1/1	6	6/5	8	1/5/13

Tabela 13

Aktivite individuale të stafit akademik për vitin akademik 2024-2025		
1.	Numri i botimeve monografi nga personeli akademik	1
2.	Numri i botimeve në revista shkencore nga personeli akademik	26
3.	Numri i projekteve kërkimore të fituara/zbatuara në shkallë Departamenti/Fakulteti	–
4.	Numri i aktiviteteve shkencore të organizuara nga KUQ	15
5.	Numri i pedagogëve pjesëmarrësve në aktivitete shkencore(konferenca)	16

Leksioni i hapur me studentët e programit të Integruar në Drejtësi “Procesi i Shitblerjes së Shoqërive tregëtare: Aspekte Kontraktuale” 07 Maj 2025 Fakulteti i Drejtësisë i Kolegjit Universitar “Qiriazi” organizoi një leksion të hapur për studentët e programit të Integruar Master i Shkencave në Drejtësi, ku u diskutuan tema aktuale dhe praktika profesionale në fushën e drejtësisë, duke nxitur dialogun akademik dhe zhvillimin e njohurive teorike dhe praktike. Leksioni gjithashtu ofroi mundësi për pyetje dhe diskutime interaktive, duke lehtësuar lidhjen mes teorisë dhe praktikës profesionale.(Lektor: Kristaq Profkola)

Teoria takohet me praktikën, nga auditorët në sallën e gjyqit. 17 Maj 2025. Studentët e Drejtësisë u bënë pjesë e Workshopit, ku teoria u takua me praktikën në sallën e gjyqit, duke aplikuar njohuritë e fituara në auditor në raste reale dhe duke forcuar

aftësitë praktike në fushën e drejtësisë dhe procedurave ligjore. Aktiviteti gjithashtu ndihmoi në zhvillimin e aftësive analitike, komunikimit profesional dhe kuptimin e rolit të institucioneve gjyqësore në praktikë.

Gjithashtu stafi dhe studentë ishin prezent në promovimin e librave/ monografi me autorë dy pedagogë të Universitetit Qiriazhi, Dr Ida Kruti dhe Dr. Gjovalin Gjeloşi 01. Nëntor 2025, duke nxjerrë në pah kontributin e tyre akademik dhe rëndësinë e literaturës në zhvillimin e njohurive në fushat përkatëse.

Monitorimi dhe raportimi i të dhënave mbi kualifikimin dhe rritjen akademike dhe shkencore të personelit akademik që mbulon Programet e Studimit që ofrohen në IAL-në tonë lidhet me planin strategjik të zhvillimit të KUQ, i cili përsa i përket Personelit Akademik dhe prioritetëve në kualifikimin e personelit akademik ka si objektiva:

Zhvillimin dhe zbatimin e politikave rekrutuese transparente për një personel akademik sa me kualitativ. Zbatimin e politikave që nxitin rritjen e performancës së personelit dhe kërkimit shkencor. Krijimin e një mjedisi të shëndetshëm e miqësor në Kolegj. Nxitja e mendimit dhe diversitetit akademik e shkencor të personelit akademik dhe krijimi i mundësive për lëvizjen e stafit në hapësirën evropiane të arsimit të lartë.

Ndër indikatorët e kualifikimit akademik mbeten:

- Gradat dhe titujt shkencore;
- Eksperienca në fushën e mësimdhënies;
- Eksperienca profesionale;
- Botime akademike;
- Kualifikimet ekstra kurrikulare;

Synimi i veprimtarisë kërkimore-shkencore mbetet rritja e vazhdueshme e standarteve akademike në KUQ dhe përmirësimi sistematik i cilësisë së arritjeve të studentëve. Stafi akademik duhet të angazhohet në procesin e integritit të rezultateve të punës së tyre kërkimore-shkencore në procesin mësimor (leksione, seminare, monografi shkencore etj.).

Trajnime

“Drejtësia dhe Zgjerimi i Bashkimit Evropianë”, Ambasadori i Maltës, *Shkëlqesia e tij Z. Anthony Licari* zhvilloi me studentët e Fakultetit të Drejtësisë 28 Nëntor 2024, duke ofruar njohuri të thella mbi proceset ligjore dhe institucionale në BE

“Siguria Kibernetike, Mbrojtja e të dhënave digjitale” 14 Janar 2025: Trajnimi u organizua për pedagogë dhe studentë mbi Sigurinë Kibernetike dhe Mbrojtjen e të Dhënave Digjitale, me qëllim rritjen e njohurive dhe aftësive praktike në fushën e mbrojtjes së informacionit dhe sigurisë në mjedisin digjital (Lektor Shahin Dokuzi).

“Inteligjenca Artificiale” 22 Janar 2025 studentët dhe pedagogët ndoqën trajnimin mbi inteligjencën artificiale, ku u njohën me konceptet, aplikimet praktike dhe potencialin e teknologjive të AI për zhvillim profesional dhe inovacion (Lektor Shahin Dokuzi).

“Ndikimi i Inovacionit në Fusha të Ndryshme”, 29 Janar 2025. Pedagogët dhe studentët ndoqën një trajnim mbi ndikimin e inovacionit në fusha të ndryshme, duke njohur praktikën, teknologjitë dhe strategjitë që kontribuojnë në zhvillimin profesional dhe avancimin e sektorëve të ndryshëm. Trajnimi gjithashtu inkurajoi kreativitetin dhe mendimin kritik për identifikimin e mundësive inovative në mjediset akademike dhe profesionale (Lektor Brian Shkodrani).

“Menaxhimi i stresit gjatë periudhës së sezonit të provimeve” 06 Shkurt 2025. Studentët u njohën me teknika praktike për përballimin e stresit, organizimin e kohës dhe ruajtjen e mirëqenies psikologjike gjatë periudhës akademike intensive (Lektore: Psikologe Klinike, Eksena Qirici).

“Gjenerimi i Ideve të Biznesit dhe Shkrimi i Planit të Biznesit” 06 dhe 13 Mars 2025 Studentët u njohën me metodat kreative për zhvillimin e ideve dhe hapat praktike për hartimin e planeve të biznesit, duke forcuar aftësitë e tyre sipërmarrëse dhe menaxheriale (Lektor Leons Hasani).

Workshope

Gjatë vitit akademik 2024 - 2025 është realizuar për studentët e KUQ Workshop me temën *“Të rinjtë dhe studentët në tregun e punës: Si të realizojmë një intervistë të suksesshme punësimi”* 01 Prill 2025. Ky Workshop kishte në fokus zhvillimin e aftësive praktike për përgatitjen dhe realizimin e intervistave të punës, duke ofruar strategji të dobishme për rritjen e mundësive të punësimit për studentët.

“Sfidat e të rinjve në tregun e punës dhe botën universitare” 09 Prill. Duke njohur sfidat dhe mundësitë që hasin në procesin e arsimit të lartë dhe integritit në tregun e punës studentët morën udhëzime praktike dhe këshilla për zhvillimin profesional.

Fuqizojmë gratë dhe vajzat në sektorin e turizmit, 21 Dhjetor 2024

Workshpi me **“Fuqizojmë gratë dhe vajzat në sektorin e turizmit”** synoi të promovojë pjesëmarrjen aktive dhe aftësitë profesionale të grave dhe vajzave në këtë sektor, duke nxitur zhvillimin e qëndrueshëm dhe barazinë gjinore. Ky workshop u mbajt me studentët e programit të Kujdesit Social dhe Shëndetësor.

“Industria Automotive” 13 Prill 2025

Studentët e programit TI zhvilluan **praktikë në industrinë automotive**, duke aplikuar njohuritë teorike në mjedis profesional dhe duke forcuar aftësitë praktike dhe teknike në fushën e inxhinierisë dhe teknologjisë së automjeteve. Praktika gjithashtu ofroi mundësi për njohje të procesit të prodhimit, menaxhimin e pajisjeve dhe standardeve të cilësisë në industrinë automotive.

Seanca teoriko-praktike në Industrinë Metalurgjike 2025-04-14

Studentët e programit të TI zhvilluan **seancë teoriko-praktike në industrinë metalurgjike, ku aplikuan njohuritë teorike në mjedis praktik dhe forcuan aftësitë profesionale në proceset dhe teknologjitë e industrisë metalurgjike.** Ky aktivitet gjithashtu mundësoi njohjen me standardet e sigurisë, menaxhimin e materialeve dhe procedurat operative të sektorit metalurgjik.

e. Vlerësimi i performacës së personelit akademik

Në zbatimin e objektivave të sipërcituara janë angazhuar strukturat përkatëse të institucionit, si njësitë bazë të cilat monitorojnë aktivitetin shkencor të personelit akademik, si edhe njësi mbështetëse, që ndërveprojnë aktivitetin shkencor të personelit sikurse është Njësia e Kërkimit Shkencor dhe me marrëdhënieve me Jashtë, (ZMJP&KK), NJSBC dhe Zyra e Burimeve Njerëzore (ZBNJ).

NJSBC ka miratuar “Formularin për vlerësimin e performancës në fushën akademike e kërkimore-shkencore” i cili është aplikuar për herë të parë gjatë vitit 2024-2025 me pedagogët, si dhe drejtuesit e njësive bazë dhe kryesore. Ky formular ka qenë i detyrueshëm për t’u plotësuar në fund të vitit akademik dhe ka patur problematikë gjatë plotësimit.

Njësia me të cilën realizohet koordinimi lidhur me të dhënat e kualifikimeve të personelit akademik është ZBNJ, ku raportohet për çdo kualifikim nga ana e stafit akademik, si marrja e gradave shkencore ose titujve shkencore, materialet certifikuese të punës kërkimore-shkencore të personelit akademik dhe dokumentacionin përkatës nga ana e personelit akademik në dosjet e tyre personale të punës.

f. Performanca e studentëve (2024-2025)

Kjo performancë vëzhgohet përmes vënies në funksionim të një mekanizmit monitorues. Ky mekanizëm në vetëvete përbën edhe një gjetje apo tregues të cilësisë dhe mbështetet mbi pesë shtylla apo elementë që konsistojnë në:

- Vijueshmërinë e tyre në leksione, pjesëmarrjen dhe angazhimin në zhvillimin e debatit dhe të shkëmbimit të opinioneve në grupe gjatë orëve të seminarit.
- Nivelin cilësor të angazhimit të tyre në procesin e debatit dhe shkëmbimit praktik të opinioneve gjatë zhvillimit të orëve të seminareve, përmes ballafaqimit të kazuseve nga praktika gjyqësore, administrative, si dhe në biznese.
- Përmes organizimit të Detyrave të Kursit, shpërndarjes së tematikave synohet reagimi i studentëve, duke rritur ndjeshëm shanset e identifikimit të nivelit të cilësisë së tyre në lidhje me shprehjen dhe kohezionin e dijeve dhe të arritjeve të tyre akademike.
- Kolokiumeve semestrale: Në hartimin e tezave në këtë “ballafaqim student-pedagog” i është kushtuar vëmendje e veçantë arritjes së vlerës praktike të tezave. Mënyrat e testimit kanë krijuar avantazh të padiskutueshëm si për studentin, i cili ka pasur në posedim hapësirën e nevojshme shprehëse të dijeve të tij, ashtu dhe për pedagogun që ka ushtruar në mënyrë të ndërsjelltë një kontroll më të gjerë dhe më efikas mbi përgatitjen e studentit.
- Lidhur me realizimin e praktikave për çdo program studimi ka një dosje të praktikës

me dokumentat përkatës. Nga një model gjendet në NJSBC.

- Provimi përfundimtar është realizuar me anën e provimit të përgjithshëm apo të punimit për mbrojtjen e diplomës.

Shënim: Të dhënat e sipërpërmendura gjenden si në raportet e pedagogëve nr. 197 prot., dt. 30. 06.2025, raportet semestralë të studentëve nr. 148 prot., dt. 22. 04. 2025, nr. 198 prot., dt. 30.06.2025, si dhe raportin i relacioneve lëndore semestrale, të cilët janë hartuar për çdo fakultet dhe KUQ, nr. 199 prot, dt. 03. 07.2025.

g. Gjurmimi i Studentëve. Të dhëna mbi punësimin e studentëve 2023-2024

(Alumni)

Programi i studimit	Numri total të diplomuarve	Numri i të punësuarve (në përputhje me diplomën)	Numri i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën)
Msc. Financë	6	4	1
Msc. Administrim Biznesi	13	10	3
Bsc. Menaxhim Biznesi	9	5	2
Bsc. Financë	9	5	2
Bsc. Informatikë Ekonomike dhe Biznesi	7	2	3
Bsc. Menaxhim Hoteleri-Turizëm	8	5	2
Bsc. Edukim Fizik dhe Sporte	27	20	3
Asistent Ligjor dhe Administrativ (Program Profesional 2-vjçarë)	11	7	3
Kujdes Social dhe Shendetësor (Program Profesional 2-vjçarë)	7	4	3
Teknologji Ushqimore (Program Profesional 2-vjçarë)	17	4	11
Hoteleri-Turizëm (Program Profesional 2-vjçarë)	3	3	
Teknologji Informacioni (Program Profesional 2-vjçarë)	7	3	3

h. Marrëdhënia me bashkëpunëtorët në kuadër të nënshkrimit të marrëveshjeve për vitin akademik 2024-2025.

Edhe gjatë këtij viti në fokus të IAL-së ka qenë nënshkrimi i marrëveshjeve me IAL të tjera duke patur si qëllim shkëmbimin e stafëve, kryerjen e aktiviteteve të përbashkëta shkencore. Një vend të veçantë ka lidhja e marrëveshjeve me sipërmarrje të ndryshme për kryerjen e praktikave të studentëve.

Institucioni	Qëllimi	Data e nënshkrimit	Kohëzgjatja
Universiteti Publik “Kadri Zeka”, Gjilan, Kosovë	Shkëmbim i stafit akademik, marketing i përbashkët, bashkëpunim në projekte ndërkombëtare, aplikim i përbashkët për fonde që mbështesin kërkimin, studentët dhe stafin, bashkëpunim në botime dhe kërkim shkencor, zhvillimi i konferencave, trajnimeve të përbashkëta, shkëmbim planesh dhe programesh mësimore-shkencore	06/12/2024	5 vjet
International Black Sea University, Tbilisi, Gjeorgji	Shkëmbim i studentëve, stafit akademik dhe administrativ, i aktiviteteve kulturore, mbajtja e seminareve, konferencave, trajnimeve, workshopeve të përbashkëta, shkëmbim i materialeve kërkimore, mësimore, bashkëpunim në projekte	02/12/2024	5 vjet
Placement in Portugal, Lisbon, Portugali	Internshipe në Portugali për studentët	23/10/2024	Pa afat
Radom Academy of Economics, Radom, Poloni	Shkëmbim i studentëve, stafit akademik dhe administrativ, shkëmbim i materialeve kërkimore, mësimore, promocion i bashkëpunimit kulturor, mbajtja e seminareve, konferencave, trajnimeve, workshopeve të përbashkëta	27/8/2025	3 vjet
Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës	Shkëmbim i stafit akademik, bashkëudhëheqje doktoraturash, bashkëpunim në botime dhe kërkim shkencor, zhvillimi i konferencave, trajnimeve të përbashkëta, bashkëpunim në projekte, shkëmbim planesh dhe programesh mësimore-shkencore	23/10/2024	5 vjet
Autoriteti i Konkurrencës	Shkëmbim informacioni, i akteve ligjore dhe rregullatore, trajnime të përbashkëta, dispozicion i ambienteve, praktika profesionale për studentet, mundesi studimi	04/03/2025	Pa afat
Mulliri i Vjetër	Praktikë profesionale për studentët e Fakultetit të Ekonomisë	Mars 2025	Pa afat

Restorant Allushi	Praktikë profesionale për studentët e Fakultetit të Ekonomisë	Mars 2025	Pa afat
Qafshatama	Praktikë profesionale për studentët e Fakultetit të Ekonomisë	Mars 2025	1 vit
Bashkia Shijak	Praktikë profesionale për studentët e Fakultetit të Ekonomisë	Mars 2025	1 vit
Union Bank, Lushnje	Praktikë profesionale për studentët e Fakultetit të Ekonomisë	Mars 2025	Pa afat
Lexalko SHA, Tiranë	Praktikë profesionale për studentët e Fakultetit të Ekonomisë	Mars 2025	Pa afat
E & B, Tiranë	Praktikë profesionale për studentët e Fakultetit të Ekonomisë	Mars 2025	Pa afat
Auto Pasion, Prishtinë, Kosovë	Praktikë profesionale për studentët e Fakultetit të Ekonomisë	Mars 2025	Pa afat
Fast Net	Praktikë profesionale për studentët e Fakultetit të Ekonomisë	Prill 2025	Pa afat
AV Consulting	Praktikë profesionale për studentët e Fakultetit të Ekonomisë	Prill 2025	Pa afat
ATC Studio Kontabiliteti	Praktikë profesionale për studentët e Fakultetit të Ekonomisë	Prill 2025	Pa afat
Bujtina Peraj	Praktikë profesionale për studentët e Fakultetit të Ekonomisë	Mars 2025	Pa afat

i. Funksionimi i klubeve studentore

Të dhëna mbi klubet studentore viti akademik 2024-2025

Pozicioni	Programi	Emri Mbiemri	Klubi
Kryetar	PIND	Erjon Nano	Klubi i Librit
Nenkryetar/e	PIND	InxhiMema	Klubi i Librit
Kryetar/e	Menaxhim Biznesi	Klea Murrja	Klubi Social
Nenkryetar/e	Edukim Fizik dhe Sporte	Klaudia Balla	Klubi Social
Kryetar/e	Administrim Biznesi	Eldis Arrnjeti	Klubi i Inovacionit
Nenkryetar/e	PIND	Erjon Nano	Klubi i Inovacionit
Kryetar/e	Informatike Ekonomike dhe Biznesi	Milena Kermaku	Klubi EkonoMIX
Nenkryetar/e	Menaxhim Biznesi	Klea Murrja	Klubi EkonoMIX
Koordinator/e	Menaxhim Hoteleri Turizem	Kledia Demo	Klubi EkonoMIX
Kryetar/e	Edukim Fizik dhe Sporte	Xhaferr Kazo	Klubi i Sporteve
Nenkryetar/e	Edukim Fizik dhe Sporte	Klejdi Hoxha	Klubi i Sporteve
Koordinator/e	Edukim Fizik dhe Sporte	Mersin Mustafaj	Klubi i Sporteve

Për Kolegjin Universitar “Qiriazi”, festimi i Ditës Kombëtare të Alfabetit në Manastir është tashmë një traditë e përvitshme. Institucioni në bashkëpunim **me klubin studentor të librit** ka kontribuar me aktivitete simbolike si ekspozita fotografike dhe punime

shkencore. Këtë vit, u dha mbështetje e veçantë për bibliotekën “Linkest” përmes pajisjeve dhe fondeve të librave, në bashkëpunim me Odën Ekonomike të Maqedonisë Veri-Perëndimore dhe “Horizon School”.

Klubi social në bashkëpunim me stafin e Kolegjit Universitar “Qiriazi”, organizuan aktivitetin “Solidaritet dhe Dashuri për Festat e Fundvitit”, duke përhapur solidaritet dhe duke sjellë gëzim për komunitetin. Aktiviteti përfshiu dhurime dhe mesazhe mirësie, duke nxitur bashkëpunimin dhe vlerat humane midis pjesëmarrësve.

Klubi sportiv ka organizuar disa aktivitete si **“Një ditë e paharrueshme për grupin tonë të studentëve në Brezovicë” 23.12. 2024**. Aktivitetet e organizuara për studentët kombinuan argëtimin, natyrën dhe zhvillimin e bashkëpunimit dhe lidhjeve ndërpersonale.

Udhëtimi i studentëve të vitit të tretë të Fakultetit të Sporteve, Universiteti “Qiriazi”, në Brezovicë 02.02. 2025.

Studentët e vitit të tretë të Fakultetit të Sporteve zhvilluan një udhëtim në **Brezovicë**, një aktivitet që kombinonte argëtimin, aktivitetet fizike dhe forcimin e bashkëpunimit dhe lidhjeve ndërpersonale midis studentëve. Gjatë udhëtimit, studentët patën mundësinë të zhvillonin aftësi të reja sportive dhe të përforconin frymën e skuadrës dhe bashkëpunimit.

Studentët zhvilluan **pranë Parkut Olimpik “Feti Borova”** praktikë, ku aplikuan njohuritë teorike në aktivitete praktike sportive, forcuan aftësitë fizike dhe zhvilluan bashkëpunimin dhe disiplinën në një mjedis profesional. Aktiviteti gjithashtu ofroi mundësi për të kuptuar rëndësinë e planifikimit të stërvitjeve, teknikave sportive dhe menaxhimit të ngjarjeve në sektorin e sportit.

Studentët zhvilluan **pranë Federatës Shqiptare të Futbollit praktikë**, ku njohën strukturën organizative, funksionet administrative dhe menaxhimin e aktiviteteve sportive, duke aplikuar njohuritë teorike në një mjedis profesional dhe duke forcuar

aftësitë praktike në fushën e sportit. Praktika gjithashtu ofroi mundësi për të kuptuar më mirë proceset e zhvillimit të lojërave, organizimit të stërvitjeve dhe rolit të federatës në promovimin e futbollit në vend.

Studentët e programit **Edukim Fizik dhe Sporte** zhvilluan **një aktivitet tek Kalaja e Petrelës**, ku aplikuan njohuritë teorike në aktivitete fizike dhe sportive, forcuan aftësitë praktike dhe bashkëpunimin ndërstudentor, dhe u njohën me menaxhimin e aktiviteteve në mjedise natyrore. Ky aktivitet u ofroi mundësi për zhvillim profesional dhe vlerësimin e parametrave fizikë dhe teknikë në ambientet jashtë kolegjit.

Klubi i ekonomisë ka organizuar “Vizitë në Muzeun e Bankës së Shqipërisë”
10 Prill 2025.

Studentët e fakultetit të Ekonomisë organizuar nga klubi i ekonomisë vizituan **Muzeun e Bankës së Shqipërisë**, ku u njohën me historikun e parasë dhe sistemin bankar shqiptar, rëndësinë e zhvillimeve financiare dhe rolin e edukimit ekonomik në kuadër të arsimit profesional dhe akademik. Vizita gjithashtu ndihmoi në zhvillimin e njohurive praktike dhe përceptimin më të qartë të funksionimit të institucioneve financiare në vend.

IV. VLERËSIMI I INSTITUCIONIT MBI SIGURIMIN E CILËSISË DHE REKOMANDIME

Institucioni ynë ndodhet në fazën e zhvillimit të mëtejshëm dhe konsolidimit të standardeve dhe mekanizmave ekzistuese të cilësisë në kuadër hapësirës mbarë evropiane të Arsimit të Lartë por edhe të përafrimit të politikave dhe strategjive të reja në lidhje me kriteret e cilësisë. Proceset, që kanë karakterizuar politikën e cilësisë gjatë vitit akademik 2023 -2024 nga KUQ mund të veçojmë:

- a. Aktivitetet e mësimdhënies;
- b. Aktivitete të karakterit kërkimor-shkencor;
- c. Performanca e studentit;
- d. Marrëdhëniet me jashtë në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar;
- e. Akreditimi periodik institucional dhe procese të tjera akredituese në nivel programor.

Lidhur me *mësimdhënien* janë konsoliduar përpjekjet për zhvillimin cilësor të leksioneve dhe seminareve dhe krijimi i një atmosferë sa më bashkëkohore, ku padyshim teknologjia si dhe metodat e adoptuara luajnë një rol parësor.

Gjatë vitit akademik 2024 - 2025, KUQ ka vijuar një politikë konstante në lidhje me zhvillimin dhe zgjerimin e hapësirave kërkimore shkencore brenda institucionit tonë, duke u mundësuar pedagogëve botimin në revistën shkencore “Kyrias” dhe pjesëmarrjen në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare organizuar nga institucioni.

Lidhur me *performancën e studentëve* është adoptuar formula që siguron një zhvillim të vazhdueshëm të performancës së studentit, si dhe rritje të cilësisë së bashkëveprimit student – pedagog. I gjithë personeli akademik angazhohet në procesin e integritimit të rezultateve të punës së tyre kërkimore- shkencore në procesin mësimor (leksione, seminare, monografi shkencore etj.).

Për këtë qëllim sugjerohet të organizohen seminare dhe tryeza diskutimesh akademike, me pjesëmarrjen e përbashkët të personelit akademik dhe studentëve. Në këto veprimtari anëtarët e personelit akademik përditësojnë njohuritë e studentëve me të

rejat nga veprimtaria e tyre hulumtuese dhe ndihmojnë në mjeshtërimin e kompetencave në përputhje me fushat e ekspertizës. Performanca e studentëve gjatë këtij viti akademik është realizuar përmes vënies në funksionim të mekanizmave monitorues dhe rezultatet e arritura janë të përmendura edhe më sipër në këtë raport.

Për sa i përket *marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe marrëdhënieve me jashtë në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar*, mund të cilësojmë se KUQ po zhvillon përpjekjet e tij për shtrirjen e projekteve të bashkëpunimit dhe anëtarësimit me IAL brenda dhe jashtë vendit, bashkëpunimi me organizata kombëtare dhe ndërkombëtare, angazhime në projekte të ndryshme, zgjerimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit me kompani të mirënjohura biznesi, institucione dhe sektorë publik etj.,

Për vitin akademik 2024-2025 janë nënshkruar 18 marrëveshje bashkëpunimi në nivel institucional, me shkolla të larta, universitete, akademi, kompani private, studio ligjore, institucione shtetërore, organizata jofitimprurëse dhe shoqata të ndryshme. Aktualisht institucioni ka 130 marrëveshje nga të cilat 24 ndërkombëtare.

Për zhvillimin e marrëdhënieve me jashtë të institucionit fushat e veprimit përfshijnë:

1. Përafrimin e programeve të lëndëve me standardet e universiteteve perëndimore;
2. Nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me IAL të ndryshme (kryesisht ato perëndimore) dhe qendra kërkimore apo institute të kërkimit shkencor;
3. Shkëmbimi i përvojave në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor;
4. Nxitja e punës kërkimore tek stafi dhe mbështetja e stafit për punën kërkimore dhe sigurimi i pjesëmarrjes së stafit akademik në aktivitete ndërkombëtare shkencore, konferenca ndërkombëtare shkencore, botime në revista me faktor impakti etj;

Për sa i përket *këndvështrimit të NJSBC*, gjejmë që disa prioritete duhet të mbahen në konsideratë të vazhdueshme:

- Duhet të përmirësohen linjat e komunikimit, si në aspektin e personelit akademik me njëri-tjetrin ashtu edhe ndërmjet këtyre të fundit me studentët.
- Duhet të nxitet pjesëmarrja e personelit akademik në sa më shumë konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, në botime shkencore në revista ndërkombëtare të indeksuara me faktor impakti apo aktivitete të tjera të karakterit shkencor me qëllim që praktika e marrë nga stafi të shërbejë në nxitjen dhe zhvillimin e vazhdueshëm të cilësisë së procesit të mësimdhënies.